

HAKI HYSENAJ

**RRAFSHIMI I KUNDËRVËNIES *r* - *R*
NË SHQIPEN STANDARDE NË KOSOVË**

Hyrje

Kundërvënia fonologjike **r-R**, në varietetin e folur të shqipes standarde në Kosovë, dhe në përmasa më të vogla edhe në variantin e shkruar, është duke kaluar fazën e fundit të rrafshimit. Matjet e bëra për këtë çështje me informatorë moshash, gjinish e nivelesh të ndryshme arsimimi, tregojnë se ky shfonologjizim është duke ndikuar njëkohësisht edhe në lindjen e një varianti të ri tingullor, i cili në aspektin nyjëtimor dallon nga dridhëset ekzistuese dhe, për pasojë, edhe në variantin e shkruar të shqipes standarde sot dalin ngatërrime të shumta në përdorimin e kundërvënies **r-R**.

Në aspektin nyjëtimor duket se realizimi i këtij varianti qëndron midis tingujve **r** dhe **rr**, e para dridhëse majëgjuhore-trysnore me një dridhje, ndërsa e dyta po ashtu me të njëjtat tipare, veçse me më shumë se një dridhje. Varianti për të cilin pretendojmë se paraqet një element të ri tingullor në mesin e dridhëseve të shqipes në Kosovë nyjëtimisht qëndron midis realizimeve standarde të dridhëseve **r-R**, dhe si i tillë mendojmë se është duke u stabilizuar në përdorim. Ky realizim tingullor kushtëzohet nga “*dallimi sasior*”, d.m.th. nga numri i dridhjeve, si dhe nga faktorë jashtëgjuhësorë. Në të vërtetë është tingulli **r**, të cilin Jubani (2012: 131) e radhit në kuadër të aproksimanteve (**ɹ**), që me kohë duket se e ka mënjanuar nyjëtimin nga alveolat me majë të gjuhës të mbështetur në pjesën e prapme të tyre (Ismajli, 1987: 215).

Hulumtimi ynë vërteton se ky variant i dridhëseve në shqipen standarde ka “*lëkundur*” sistemin fonematiko-fonologjik të shqipes në Kosovë. Në radhë të parë përdorimi i tij është duke ndikuar në neutralizimin e kundërvënies **r-R**. Nëse para shumë vitesh ky rrafshim ishte shënuar në të folmet urbane të jugut, si dhe në të folmen e Pejës dhe të Dibrës, sot ngulmon të bëhet normë në shumicën e të folmeve, por edhe në gjuhën standarde të folur në shumicën e vendbanimeve të Kosovës.

Në variantin e shkruar çështja më e ngatërruar. Matjet tregojnë se ka shkarje të shumta në përdorimin e dridhëseve edhe në shqipen standarde të shkruar, mirëpo në gjendjen e tanishme ato nuk ofrojnë mundësinë e krijimit të një sistemi të caktuar që do të ofronte materie të mjaftueshme për përshkrimin të saktë të gjendjes. Megjithatë, hulumtimi ynë tregon se moshat e reja, zakonisht nxënësit e shkollave të mesme dhe ata të ciklit të ulët, kanë vështirësi në dallimin e kundërvënieve në çiftet minimale, të cilat në strukturën e tyre

kanë këto dy fonema. Prandaj, rezulton se rrafshimi **r** dhe **R** në ligjërimin e shkruar sigurisht se nuk është në të njëjtën fazë me atë të ligjërimin të folur, porse nuk do mend se zhvillimet, ndonëse më të ngadalshme, kanë përfshirë edhe këtë variant të shqipes standarde, këtu në Kosovë. Kjo gjendje reflektohet në ese nxënësish e studentësh, në gjuhën e shkruar të administratës, në emërtime, në gjuhën e reklamave e të medieeve.

Rrafshim dhe reflekse

Ky zhvillim fonematik, i nisur shumë më parë në të folme të tjera të shqipes, edhe në të folmen e Kosovës, është refleksi i faktorëve të ndryshëm gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Si rrjedhojë fonemat **r** dhe **R** gjithnjë e më shpesh dalin edhe me reflekse të ndryshme, që hë për hë mund të konsiderohen si alofone. Si të tilla, në shumicën e rasteve, posaçërisht në varietetin e folur, ato nuk krijojnë opozicione fonologjike, ndërsa, siç u tha edhe më lart, në variantin e shkruar përdorimi i tyre reflekton lëkundje serioze në planin drejtshkrimor. Këto lëkundje ende identifikohen si shkarje ortografike dhe janë produkt i rrafshimit gati të tërësishëm të kundërvënies.

Në këto rrethana mund të flitet për një realitet të ri në sistemin fonetiko-fonologjik të shqipes së folur në Kosovë. Ky realitet pasqyron prirjen e vibrantes **R** për t'u njëjtësuar me pandanen e saj **r**, që do të thotë se tiparet dalluese “*sasiore*” midis këtyre dy fonemave janë duke u bërë gjithnjë e më pak relevante dhe gjithnjë e më të përafërta.

Kjo prirje vërehet në varietetin e folur të shqipes standarde në shumë qytete të Kosovës, ndërkohë që në disa të tjera, si në qytetin e Pejës, procesi ka shkuar më tej. Në varietetin e folur të gjuhës standarde në këtë qytet mungon ky opozicion fonologjik dhe në të gjitha rastet e përdorimit të këtyre dy sonanteve zë vend varianti për të cilin u fol më sipër. Ky variant, që tashmë ka gjetur shtrirje gati në të gjithë vendin, mund të përshkruhet si një tingull dridhës me numër të ndërmjetëm dridhësh dhe me një nyjëtim paksa anësor, që do të thotë se maja e gjuhës prek alveolat më pak se për **rr**-në e gjuhës standarde dhe më shumë se për **r**-në. Nga ana tjetër, duke qenë se maja e gjuhës zhvendoset tek fundi i alveolave edhe një sasi ajri kalon anash gjuhës, duke e bërë kështu këtë variant më të ndryshëm nga dy vibrantet e shqipes, të cilat edhe ashtu midis tyre dallojnë vetëm për një tipar që nuk takohet në kundërvëniet e tjera të sistemit fonetiko-fonologjik të shqipes.

Ky zhvillim fonematik hë për hë krijon vështirësi në dallimin e kuptimeve në rastet e çifteve minimale, si *ara-arra*, *ruaj-rruaj*, *remi-Rremi*, *rasa-rrasa*, prandaj në trajtën e folur ngatërrimet zënë të shthuren vetëm në kuadër të kontekstualizimit të thënieve. Në shumë raste e njëjta gjë ndodh edhe në gjuhën e shkruar. Edhe në këto situata vetëm konteksti ndihmon në marrjen e informacionit të saktë.

Metodologjia dhe hulumtimi

Pohimet e mëparshme, për rrafshim dhe reflekse të këtyre fonemave, bazohen në hulumtimin e përdorimit të tyre në ligjërimin e folur e të shkruar të nxënësve dhe studentëve, si edhe të folësve *eminentë* të shqipes standarde (folës eminentë i kemi konsideruar spikerët profesionistë dhe moderatorët e televizioneve).

Rezultatet e anketës sonë gjuhësore, realizuar me nxënës të shkollave të mesme, me theks të veçantë në qytetin e Pejës, dhe me studentë të Universitetit të Prishtinës, si dhe hulumtime të tjera të ngjashme (incizime), të realizuara në terren, kanë vërtetuar lëkundjet e sistemit të ndërlidhnive në shqipe, posaçërisht kur bëhet fjalë për fonemat **r** dhe **R**.

Për punimin tonë kemi konsultuar edhe hulumtimet e studentëve (me pëlqimin e tyre), të bëra në terren për përdorimin e shqipes standarde, të cilat i kanë shfrytëzuar si prova për konstatimet e tyre në punimet e diplomës për nivelin master.

Anketat dhe incizimet e bëra në terren kanë mundësuar edhe identifikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë që kanë ndikuar në rrafshimin e kësaj kundërvënije, si dhe përdorimin gjithnjë e më të shpeshtë të variantit të përshkruar më lart.

Përgjigjet e të anketuarve që jetojnë në zona urbane, bazuar në rezultatet e përshkrimit të gjuhës së përdorur nga studentët e UP-së, dëshmojnë se procesi i rrafshimit është në përfundim e sipër në shumicën e qyteteve të Kosovës, ndërsa përgjigjet e të anketuarve nga zonat rurale dëshmojnë ende karakterin funksional të kësaj kundërvënije, por të zbehur në masë. Megjithatë, matjet tregojnë se kjo kundërvënie ka pësuar lëkundje të shumta në varietetin e folur nga brezi i ri edhe në këto zona.

Statusi i kundërvënies

Studimet e deritashme rreth këtij procesi, i nisur shumë vite më parë për të folme të ndryshme të shqipes, fillimisht për të folmet toske, kanë vënë në pah vetëm faktorët gjuhësorë, siç është ngarkesa jo e madhe funksionale e kundërvënies (Dodi 2004: 100) dhe jostabiliteti i saj për shkak të përjashtimit fonologjik që paraqet në sistemin bashkëtingëllor të shqipes, pasi që ngrihet mbi bazë të kuantitetit, tipar që është treguar edhe joekonomik në shqipe (Ismajli 1987: 100).

Siç dihet, fonemat **r** - **R** janë pjesë e sistemit fonetiko-fonologjik të shqipes standarde, të kodifikuara në normë. Sipas saj, ato do të duhej të hynin në raporte kundërvënëse, duke shfrytëzuar tipare të ndryshme nyjëtimore dhe akustike që përshkruhen t'i kenë.

Fonemat **r** dhe **R**, bazuar në përshkrimet që u janë bërë deri tashti, formojnë opozicion fonologjik mbi bazë të gjatësisë, të intensitetit dhe të numrit të dridhjeve. Opozicioni është më tepër i karakterit sasior. “*Dallimi*

midis tyre konsiston në sasinë e dridhjeve, që në fakt është një kompleks fonetik: bashkë me numrin e dridhjeve kemi intenzitetin, sasinë, sonoritetin etj.” (Ismajli 1985: 190).

Aljula Jubani-Bengu e konteston tiparin e numrit të dridhjeve si diferencues opozicional midis fonemave **r-R**. Duke u mbështetur në rezultatet e analizave të saj, Jubani konstaton se “*e ashtuqajtura njëdridhëse e shqipes standarde nuk paraqitet me dridhje, por ka strukturën e një aproksimanteje*” (Jubani 2012: 131).

Nga ana tjetër, matjet tona të tipareve të këtyre dy fonemave, kur ato ndodhen në pozita të izoluar, kanë treguar se **r**-ja del më e përparme, më e hapur, më e shkurtër, më pak intensive dhe më pak sonore se **R**-ja (Hysenaj 1992:100). Vendi i formimit nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në këtë kundërvënie, prandaj sot ka aq shumë mundësi për një fushë më të gjerë dispersioni të /**R**/-së, e cila, në të njëjtën kohë, shumë vite më parë edhe në varietetin standard të shqipes në Kosovë, kishte krijuar mundësi për reflekse dhe variante të mundshme në kuadër të sistemit fonematik të shqipes. Pikërisht kjo mundësi, e shkaktuar nga fusha e gjerë dispersive e kësaj foneme, është vërtetuar edhe në rezultatet e këtij punimi, të cilat mbështesin pohimin për shfaqjen e një varianti që dallon cilësisht nga vibrantet e shqipes, në njërin anë, dhe në anën tjetër për faktin se po ky variant ka ndikuar në shfonologjizimin e kësaj kundërvënieje.

Një vit pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), Rexhep Ismajli thotë se në të folmet e vendbanimeve urbane të jugut është zhdukur ky dallim midis vibranteve. Shton se në gjuhën standarde dallimi sasiore midis tyre megjithatë ekziston dhe bën pjesë në kodin e normës drejtshqiptimore, ashtu siç na del edhe në shumicën e të folmeve të tjera, sidomos në veri (Ismajli 1987: 2015).

Realiteti i ri gjuhësor, i krijuar këto dy deceniet e fundit, tregon se procesi i rrafshimit midis këtyre dy fonemave ka gjetur shtrirje edhe në të folmet veriore, duke mos kursyer edhe varietetin standard të gjuhës. Në këtë rast dialekti duket se ka ndikuar mbi standardin, dukuri kjo jo shumë e shprehur as në gjuhët e tjera. Dialektizimi i gjuhës standarde mbetet një fushë e rëndësishme për studime gjithëpërfshirëse në shqipe.

Belluscio e kundërshton neutralizimin e kësaj kundërvënieje, si dhe mundësinë e të qenit funksional në shqipen e folur në Kosovë një variant “*i rī*” tingullor vibrant, i cili, sipas nesh, ka shkaktuar këtë neutralizim të kësaj kundërvënieje. Megjithatë, Belluscio pranon se përdorimi i *rr*-së si e tillë (d.m.th. si shumëdridhëse, në vend të *r*-së) “nuk do të ngacmonte vëmendjen e dëgjuesit”. Këtë konstatim autori e bazon në rezultatet e anketës “*al volo*” të realizuar me folës të ndryshëm të shqipes me pyetjen rreth prestigjit të disa prej dukurive të shqipes standarde (Belluscio, 2016: 416).

Hulumtimi ynë tregon se opozicioni fonologjik midis këtyre dy fonemave në shqipen e Kosovës gati se ka përfunduar. Funkcionaliteti i kësaj kundërvënieje, sipas materialeve të mbledhura në terren, vërehet pjesërisht vetëm në zonat rurale të vendit dhe kjo në gjuhën e folur të njerëzve të moshuar. Madje, edhe në këto zona, te brezi i ri i folësve të shqipes standarde, janë shënuar lëkundje serioze në dallimin e r-së nga rr-ja dhe anasjelltas.

Korpusi dhe të gjeturat

Për të vërtetuar pohimet për gjendjen sot të këtyre dy fonemave në shqipen e folur dhe për të parë edhe shkarjet që bëhen në trajtën e shkruar të standardit ne kemi provuar që me ndihmën e një ankete gjuhësore dhe me materiale të incizuara gjuhësore të nxjerrim përfundime konkrete. Për këtë qëllim edhe gjuha e mediejeve elektronike ka qenë pjesë e hulumtimit tonë.

Anketa është plotësuar nga 85 maturantë të gjimnazit “Bedri Pejani” të Pejës, 74 prej të cilëve kanë lindur dhe jetojnë në qytet, ndërsa 14 të tjerë në fshatra të ndryshme. E njëjta anketë është plotësuar edhe nga 80 studentë të Fakultetit të Filologjisë të UP-së. Të anketuarit kanë përfaqësuar shumicën e qyteteve të Kosovës.

Anketa dhe përgjigjet e nxënësve që jetojnë në qytet:

Anketa është përbërë nga 25 fjali. Çdonjëra ka përmbajtur së paku një fjalë që ka filluar me njëren nga fonemat dridhëse. Të anketuarit kanë pasur për detyrë të plotësojnë hapësirat e zbrazëta për tingujt r dhe rr. Në mesin e këtyre fjalive kanë qenë edhe çiftet minimale: **ara/arra, rasa/rresa** dhe **ruaj/rruaj**.

Në çiftet minimale: **ruaj-rruaj; ara-arra** dhe **rasa-rresa** kundërvënia r – R nuk dallohet nga 54 nxënës, ose shprehur në përqindje nga 76%, ndërsa 17 prej tyre, ose 24%, e kanë bërë dallimin pjesërisht.

Anketa dhe përgjigjet e nxënësve me origjinë nga fshatrat:

Të gjithë të anketuarit nga fshatra, d.m.th. 14 sish, me hamendje të vogla e bëjnë dallimin midis dy fonemave, posaçërisht kur janë në ndodhur në çifte minimale. Ndërkaq, në varietetin e folur është vërejtur e theksuar tendenca për rrafshimin e kësaj kundërvënieje fonologjike.

Rezultat janë gati të ngjashme edhe për fjalët që nisin me rr. 59 nxënës nga qyteti, ose 83%, në vend të fonemës rr të fjalëve: **rrahu, rrallëherë, rraskapitur, i derrave, terri, rrugë, rrebesh, rrethi, rrezet, rrëmuje, rruga, rreptësi, rrrathë** dhe **rrush përdorin fonemën /r/**, ndërsa 12 prej tyre, ose 17 % i shkruajnë drejt këto fjalë.

Nga nxënësit me origjinë nga fshati vetëm 4 prej tyre ngatërrojnë pjesërisht përdorimin e këtyre dy fonemave. Edhe te këta nxënës vërehet tendenca e përdorimit të fonemës r në vend të R. Gjithnjë kemi të bëjmë me rezultate nga varianti i shkruar i gjuhës standarde.

Bazuar në përgjigjet e këtyre informatorëve mund të konkludohet se rrafshimi i këtij opozicioni fonologjik, në gjuhën e folur në qytetin e Pejës është në fazën e fundit të funksionimit. Ky “*zhvillim*” gjuhësor ka përfshirë edhe gjuhën e administratës, gjë që dëshmohet, pos tjerash, edhe me emërtimet aktuale, që në vete përmbajnë vibrantet **r-R**. P.sh. në Pejë ndeshim emërtimet: “*Karagaq*” në vend të “*Karragaq*”, “*Mbreti Piro*” (emër rruge) në vend të “*Mbreti Pirro*”.

Këto matje janë bërë vite më parë dhe rezultatet e prezantuara edhe në këtë punim shprehin progresivitetin e zhvillimit të këtij procesi sipas periudhave të ndryshme pas “liberalizimit” të përdorimit të standardit të gjuhës.

Edhe matjet më të reja, bërë vitin e fundit (2017), kanë treguar se folësit e gjuhës standarde, fillimisht në qytetin e Pejës, e më vonë edhe në qytete të tjera të vendit e kanë rrafshuar gati në tërësi këtë opozicion fonologjik. Rezultatet krahasuese, që dëshmojnë prirjet e këtij procesi, janë nxjerrë nga matjet që i kanë bërë studentët e nivelit master në qendra të ndryshme të Kosovës.

Edhe rezultatet e dala nga anketa e realizuar me studentë të Fakultetit të Filologjisë janë gati të përafërta me rezultatet e mësipërme. Të njëjtën anketë e kanë plotësuar 80 studentë të qyteteve të ndryshme të Kosovës. P.sh. nga 23 të anketuar, studentë të lindur në Prishtinë, 11 prej tyre, ose 49% nuk njohin opozicionin fonologjik **r - R**, ndërsa fjalët që fillojnë me **rr** në 61 % të rasteve janë shënuar me **r**. 57 studentët e tjerë, që janë nga qendrat kryesore të vendit, kanë bërë të njëjtat shkarje. Përqindjet kanë dalë të përafërta.

Nga përvoja e gjatë e punës me studentë kemi hetuar se shumë prej tyre, në trajtën e folur, fjalët që fillojnë me fonemën **R** i shqiptojnë me variantin e përmendur më parë, gjë që vërteton se prirja e rrafshimit të kësaj kundërvënije tashmë hetohet edhe në nivele akademike. Për të qenë rezultatet më bindëse për këtë gjë kemi incizuar 10 studentë të qyteteve të ndryshme të Kosovës.

Së fundi, duhet përmendur se rrafshimi i këtij opozicioni dhe prirja për një variant të ri tingullor, që në perspektivë mund të kryejë rolin e një foneme të caktuar për dy fonemat dridhëse të shqipes, ka prekur edhe gjuhën e folësve eminentë të standardit. Këtë konstatim e mbështesim në gjuhën e përdorur në televizionet kombëtare të Kosovës. Të kujtojmë reklamën televizive “Bira Peja është më e mira”, në të cilën në vend të vibrantes **r** spikerë dhe moderatorë televizionesh e radios në Kosovë sot rregullisht nyjëtojnë variantin e përshkruar në këtë punim. Të njëjtën e bëjnë edhe në togfjalëshat: **R(r)adio Televizioni i Kosovës**, **R(r)espekt** (respekt), **R(r)oman** (roman-i).

Prirjet e mëtejme

Shkaqet e këtij realiteti të ri gjuhësor në sistemin fonetiko-fonologjik të shqipes standarde të folur në Kosovë besojmë se duhen kërkuar në 3 drejtime:

Së pari është rendimenti jo i madh funksional i kundërvënies **r-R**, faktor gjuhësor që ka ndikuar në këtë lëkundje të sistemit fonetiko-fonologjik. “Dridhësja /R/ përdoret në një numër më të kufizuar fjalësh se /r/-ja”. Mbase, për pasojë edhe denduria e përdorimit është në anën e fonemës /r/. Sa për ilustrim, në tregimin *Fyelli magjik ose kambanat e humbura*, të shkrimtarit Beqir Musliu, që shtrihet në 6 faqe tekst, fonema /r/ përdoret 314 herë, ndërsa fonema /rr/ vetëm 29 herë.

Faktor i dytë për zhdukjen e këtij opozicioni fonologjik dhe i tendencës së lindjes së një tingulli që do të “*mbulonte*” zbrazëtirën e krijuar në sistem, mendojmë se është edhe nga kontakti gjuhësor me gjuhët që nuk njohin dridhëse si të shqipes. Greqishtja, italishtja dhe gjuhët sllave, gjuhë në kontakt me shqipen, njohin vetëm një fonemë dridhëse, prandaj duke qenë me prestigj një kohë të gjatë përballë shqipes mendojmë se kanë ndikuar në rrafshimin e kësaj kundërvënieje dhe në vetë mënyrën e artikulimit të dridhësive e përbërësve të saj.

Dhe së fundi, të dhënat dialektore, si dhe studimet e bëra për sistemet fonetiko-fonologjike të të folmeve të ndryshme të shqipes, dëshmojnë për rrafshim të kësaj kundërvënieje fonologjike, së pari në zonat urbane me tendencën gjithnjë në rritje edhe në zonat rurale.

Rezultatet e hulumtimit tonë, duke ndarë informatorët sipas vendit të lindjes dhe vendbanimit, përforcojnë konstatimet e deritashme. Prandaj, konsiderojmë po ashtu se krahas dy faktorëve të parë, që mund të konsiderohen esenciale në këtë rrafshim edhe faktorët jashtëgjuhësorë nuk duhet lënë anash. Këtu kemi të bëjmë me ndjenjën e banorëve urbanë për diferencim gjuhësor nga banorët ruralë. Kjo ndjenjë, në radhë të parë hetohet në fushë të leksikut, por nuk mungon edhe në sistemet e tjera gjuhësore, si në rastin tonë.

Në këtë situatë, kur mungojnë modelet nyjetimore për këto dy fonema, kujtojmë se orvatjet për ndonjë ortofoni do të rezultojnë pa sukses. Prandaj, më duket se këto dy fonema janë duke ndikuar në riformimin e sistemit fonetiko-fonologjik të shqipes standarde dhe gradualisht edhe në krijimin e ekuilibrave të reja fonologjike në standardin e saj.

Përfundime

- Si shihet, procesi i rrafshimit të opozicionit **r - R** edhe në varietetin e folur të gjuhës standarde në Kosovë konsiderohet i pjesërisht i përfunduar ose i përfunduar tërësisht, si në rastin e gjuhës së folur standarde në qytetin të Pejës.

- Në trajtën e folur as **r**-ja e as **rr**-ja nuk janë dridhëset e kodifikuara të shqipes. Ato identifikohen variante aproksimative me tendencë të njëjtësimit dhe të krijimit të një varianti të ri tingullor në shqipen e folur në Kosovë.

- Kjo gjendje na shtyn të mendojmë për një zhvillim të ri gjuhësor në shqipen e folur në Kosovë.

•Ky zhvillim kërkon analiza më të thella për të parë nëse vetëm faktorët gjuhësorë kanë ndikuar në shtrirjen e tij apo edhe faktorë të tjerë që lidhen me identitetin urban të folësve të shqipes.

BIBLIOGRAFI

- Belluscio, G., (2016), *Varietete/variante fonetike “tendenciale” në përdorimin e kontrolluar të shqipes standarde në një emision televiziv të sotëm*, në Seminari për gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare, 35/1, Prishtinë.
- Dodi, A., (2004), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, Tiranë.
- Hysenaj, H., (1992), *Tiparet akustike dhe distribucionale të tingujve të gjuhës shqipe* (punim magjistrature i botuar pjesë-pjesë në Filologji), Prishtinë.
- Ismajli, R., (1985), *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë
- Ismajli, R., (1987), *Artikuj mbi gjuhën*, Prishtinë.
- Ismajli, R., (1987), *Artikuj mbi gjuhën*, Prishtinë.
- Jubani, A., (2012), *Fonetikë akustike-analizë e sistemit fonologjik*, Tiranë.

SUMMARY

LEVELING THE OPPOSITION **r-R** IN THE STANDARD ALBANIAN IN KOSOVO

The purpose of this paper is to describe the opposition **r-R** in standard Albanian in Kosovo. This opposition has suffered in its quality in these last two decades. In the new linguistic reality, it's already possible to speak of a nearly complete equalization of this opposition and, on the other hand, of the “birth” of a new phonetic variant, among the vibrant consonants of the Albanian language. This element, which for now can be considered as “insistent” to ensure its status within the phonetic-phonological system of the Albanian language, represents a vibrant with an average number of vibrations, which means a lightly more lateral articulation than standard normative vibrants and a smaller number of vibrations, respectively less touches of the tip of the tongue to alveols than for standard Albanian **R** and a bigger number of vibrations, respectively more touches than for standard Alb. **r**.

Our research largely confirms the thesis that the **r - R** opposition leveling process in the standard Albanian variety is considered partially completed or completely completed in several cities in Kosovo.

Numerous variations in the use of these two vibrant consonants also occur in written discourse. Obviously in smaller proportions.

In the spoken form, today I think that neither **r** nor **R** do represent the normative Albanian vibrants. They can be identified as approximating variants

with the tendency of matching and creating a new consonant variant that requires positioning in the system.

This situation prompts me to think of a new language development in spoken Albanian in Kosovo.

This development requires deeper analysis to see if only linguistic factors have influenced its extent or other factors related to the urban identity of Albanian speakers.

Conclusions of this paper are based on field research.

